

VENDIM
Nr. 203, datë 1.9.2025

**MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “GLOBAL TECHNICAL MECHANICS” SHPK
NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “ç”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; neneve 4, pika 1, germa “d”, 5, pika 1, germa “d”, dhe 13 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe nenit 15 të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 1.9.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2123/7 prot., datë 28.8.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Global Technical Mechanics’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Global Technical Mechanics” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2123 prot., datë 18.7.2025, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 173, datë 31.7.2025, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë në këtë veprimtari.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 1.8.2025 dhe 2.8.2025) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 11.8.2025), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua në dy gazeta zyrtare, në rrjetet sociale të institucionit edhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.

- Me shkresën nr. 2123/3 prot., datë 5.8.2025, ERE ka njoftuar shoqërinë për vendimin e fillimit të procedurës dhe i ka kërkuar depozitimin e informacionit/dokumentacionit të aplikimit të konstatuar të paplotësuar ose të plotësuar pjesërisht.

- Shoqëria, pas dorëzimit të dokumentacionit plotësues me shkresat nr. 2123/4 prot., datë 13.8.2025 dhe nr. 2123/6 prot., datë 26.8.2025, si dhe pas kërkesave të ERE (shkresën nr. 2123/5 prot., datë 18.8.2025 dhe *e-mail*, datë 26.8.2025), në datën 28.8.2025, ka depozituar dokumentacionin e plotë të aplikimit.

Përputhshmëria e aplikimit me Rregulloren

- Nga analizimi i këtij aplikimi, rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të aneksit A të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar.

- Në referencë të përcaktimeve të Rregullores, aplikuesi ka plotësuar të gjithë dokumentacionin e kërkuar në zbatim të nenit 9, për pikën 1.1, gjerat “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, gjerat “a”, “b”, “c” dhe “d”; për pikën 1.3, gjerat “a”, “b” dhe “c”; si dhe për pikën 2.4, gjerat “a”, “b”, “c” dhe “d”.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Global Technical Mechanics” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë “Global Technical Mechanics” sh.p.k., “OST” sh.a., “OSSH” sh.a. dhe “ALPEX” sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti